

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Intervista në Syri Tv - 'SPAK ka dalë si një subjekt i ri politik'/ Strazimiri: Opozita i vetmi faktor serioz për ballë Ramës
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916601/po-vjedh-sikur-te-jete-dita-e-fundit-ne-pushtet-str-azimiri-opozita-i-vetmi-faktor-serioz-perballe-rames/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 15:09:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:53:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e4e05cb4aa5e3983bedbf9472b18d211d3180534f647e71dd11ea1d4e61d1f4a
TEKSTI	92bd4f29bf184ffee4d846849b09d5d02dce07e9d862e15a4ecc5a691246f543
PAMJA	0fb220b208f3b7ac095929180144c626503f9503cc78ee9d939dfae173f5a84a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	df6e05d4114c77d13ead0ccf5628e558b0e41c9c7aaa35669af31a3236587a57
E MËPARSHMJA	1f1c76a2115c790e378bf1b59f3bcc6f1d9ee77bbf8c602d891d47d07e98785
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/df6e05d4114c77d13ead0ccf5628e558b0e41c9c7aaa35669af31a3236587a57>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!




AGIM XHAFKA

Dialog me mbësën

LAJMI I FUNDIT

TASK FORCE/ Shqipëria e Edi Ramës dhe Ron Yeffet



më të lexuarat



Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha



Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin



'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre




Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore



Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin



Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina



'SPAK ka dalë si një subjekt i ri politik'/ Strazimiri: Opozita i vetmi faktor serioz përballë Ramës

16:53, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



I ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, deputeti i Partisë Demokratike, Gent Strazimiri, akuzoi qeverinë Rama se po vepron me nxitimin e një pushteti që e ndien fundin pranë.

Duke komentuar denoncimet e fundit të opozitës, Strazimiri tha se mazhoranca "po vjedh sikur të jetë dita e fundit në pushtet", ndërsa u ndal të lidhjet e personave të afërt me familjen e kryeministrit me struktura që administrojnë fonde publike.

Deputeti theksoi që kjo tregon se pushteti po heq dorë edhe nga përpjekja për të kamufluvar lidhjet me skemat e përfitimit nga paratë publike.

Strazimiri shprehu gjithashtu mosbesim ndaj drejtësisë së re dhe SPAK-ut, duke e akuzuar sistemin për standarde të dyfishta në trajtimin e çështjeve që prekin mazhorancën dhe opozitën.

Ai deklaroi se përballë qeverisë, faktori i vetëm serioz politik mbetet Partia Demokratike, ndërsa protestat qytetare i cilësoi si një zhvillim pozitiv, pavarësisht problemeve me organizimin dhe koordinimin.

Strazimiri tha se përballja politike dhe presioni qytetar janë rruga për t'i dhënë fund asaj që ai e cilëson si abuzim të pushtetit dhe kapje të institucioneve.

Pjesë nga intervista:



Unë mendoj që banda ka shteruar kapacitetin e vjedhjes, e ka bërë 101% realizimin e planit të vjedhjes vazhdon të vjedhë sikur të jetë dita e fundit në pushtet, po sikur të jetë ora e fundit. Merr domethënë edhe të ikjen. Veçanërisht do të doja të ndalesha tek denoncimi i fundit i kolegut Bardh Spahia në rastin me lidhjen direkte të lidhje me familjen e gruas së kryeministrit, do të thotë që ka probleme banda

brenda per brenda.

Edhe deri tani sigurisht paratë në mënyrë të tërthortë me një apo me dy stacione te familja e kryeministrit dhe xhepi i kryeministrit shkonin. Po fakti që janë detyruar të heqin kamuflimin dhe të vendosin atë personin, kushërirën e parë të gruas së kryeministrit dhe një vend që është paralajmëruar që është një strukturë e paralajmëruar që do të grabisi si fshesë me korrent të gjithë buxhetin praktikisht domethënë një lloj belindllëku tashmë në shëndetësi, tregon që banda brenda për brenda ka probleme, asnjë cent nuk lejohet të humbasë rrugës, nuk i fshihen më, e kanë krejtësisht të domosdoshme të kenë atë personin, njeriun e tyre me lidhje direkte me ta. Besoj që domethënë vetë po paralajmërojnë momentet e fundit të tyre në pushtet me këtë babëzi që kanë, me këtë ngut që kanë dhe me këtë mungesë filtri për të fshehur lidhjen direkte me vjedhjen.

Unë them që është frika e ikjes nga pushteti, përpara se të ikje vetë atë pushtetin nuk e ruan dot, mendoj unë. Pushtetin nuk e ruan dot sepse nuk është në dorë të tij, të paktën të vjedhë, e vjedh në mënyrë direkte. Nuk ka më luksin t'i humbasi gjë rrugës, nuk ka më luksin të mos ketë besim të kontrollojë bashkëpunëtorët e tjerë të bandës ku di unë, Ilir Beqjen e radhës apo ku di unë Gerta Manastirliun e radhës, po vendosin personin e tyre, njeriun e shtëpisë që t'i sjelli direkt në shtëpi lekët e të mos kemi asnjë dyshim.

Unë mendoj që e vetmja, i vetmi lojtar në fushë që është realisht përballë qeverisë është opozita politike, që do të thotë Partia Demokratike. Përsa i përket drejtësisë asgjë s'është sekret unë nuk kam pikën e besimit, te kjo drejtësi e bërë nga Edi Rama, e bërë nga Belinda Balluku. Të presësh nga e motra e Belinda Ballukut pafajësia e figurës së atyre që normalisht do duhet të na bëjnë drejtësi, do të ishte naivë të mendonit se pjella e motrës së Belinda Ballukut do të çonte në burg Belinda Ballukun. Sado që është kapur, sado që është flagrantë, sado që është publike.

Sigurisht, çështjet janë të hapura, Belinda është në rrugë, Belindës vazhdojnë i gjeihen vilat, a ka treqind, a ka tre a ka tridhjetë e një, kjo është pak, kjo ka pak rëndësi tashmë. Kjo në qoftë se nuk jemi bindur deri tani që është drejtësia e Belinda Ballukut, nuk është drejtësia e pavarur e bërë nga partnerët e tjerë e tjerë domethënë broçkulla që dëgjojmë. Në qoftë se nuk jemi bindur deri tani, atëherë domethënë nuk di çfarë duhet të ndodhë që të bindemi. Unë jam ndër ata që kam pasur që në momentin e parë, kam thënë një drejtësi e bërë me instrumenta të kalbura sovjetikë, e prekur nga duart e ndyra të kimit në parlament nuk mund të jetë ajo e duhura. Nuk mund të jetë as europiane, as euroatlantike, as drejtësi efiçiente, as drejtësi e drejtë. Kështu që nga kjo pikëpamje në qoftë se prisni përgjigje tjetër po flisni me njeriun e gabuar.

E vetmja gjë për të cilën jam angazhuar, unë edhe e kam thënë, e kam shkruar, ja them vazhdoj ta them, SPAK dhe drejtësia e re ka dalë si një subjekt i ri politik në skenë praktikisht, hera herës fërkohet me qeverinë, hera herës palidohet me qeverinë, e vetmja gjë që duket dhe është e dukshme domethënë është fakti që dhe qeveria edhe drejtësia e re SPAK-u, Altin Dumani po deshe, Arben Kraja apo ky tjetri si e ka emrin ky Arben Kraja i ri që është tani, vetmja efiçensë që kanë është që domethënë kanë mbajtur 333 ditë në arrest shtëpie, në burg praktikisht liderin e opozitës megjithëse nuk ka prova.

Megjithëse do të duhej të kishin arrestuar tashmë Taulant Ballën për kallëzim të rremë për dosjen e ashtuquajtur dosja e klubit Partizani. Kështu që nga kjo pikëpamje mos prisni që është një drejtësi që e ka bërë Belinda Balluku, nuk do t'i hyjë gjemb në këmbë Belinda Ballukut nga kjo drejtësi. E vetmja, ju thashë dhe një herë, i vetmi faktor serioz që mbetet në fushë është opozita politike, sigurisht ka një protestë qytetare herë herë të çorganizuar, herë herë jo të koordinuar, herë herë kur shikohet që po koordinohen po organizohen dhe po mpiksen, dikush del dhe e shkatërron dhe e kthen nga e para, e kthen në çorganizim të organizuar, po gjithsesi është një lajm i mirë.

i përket kësaj labele, po zhidur historia

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE',
Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë
Universitetit të Tiranës për Kolegjin e
Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë
pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin
e tyre

'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës!
Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar!
Dita e 105 e protestës në foto

© SYRI.net

Lexo edhe:



Balliu publikon videon: Shikoni si merren zvarrë, dhunohen dhe
goditen me grushta protestuesit nga policia e pushtetit



VIDEO/ Çollaku: Kemi dhe 'Timak China', qeveria karrigen në NATO paradite e mban vetë, pasdite ua jep kinezëve



Heshtja e elitave përballë çmendurisë: harrohen çamëria e kosova, ndërtohet muze për hebrejtë dhe shtet bektashi

TË NGJASHME



Edhe sa do përpëlitet SPAK përballë aferës Rama-Yeffet?



BE: I takon Kushtetutes ta gjykojë formimin e Qeverisë dhe të Kuvendit



Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa/ PD: Narkopolicia nuk do ta fitojë betejën me fjalën e lirë!



SYRI TV/ Pagat e magistratëve, debate te Ekonomia, Rama justifikohet me rëndesën në buxhet



Tabaku: Afera KAYO godet procesin e integritetit, "sistemi Rama" po pengon të ardhmen europiane të Shqipërisë



Seanca në Gjykatën e Lartë/ Nuk gjykohet kryebashkiaku, por individ i Erion Veliaj, i akuzuar për korrupsion



Mbipopullimi në shkollat e Tiranës/ Lamaj: Investime të pabarabarta në arsim, po shpopullohen periferitë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.